



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

Nr. 861/1 prot.



Fushë-Arrëz, më 25. 03. 2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 8 datë 07/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028"

Analiza ligjore: Hartimi Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve. ië Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, përgatitet në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri. Ligjit nr. 11/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni "41, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008. Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Endryshuar, neni 25, neni 26, nem 27 dhe neni 28, Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 13, neni 34, nem 35, neni 36, neni 17, neni 38 dhe neni 39, Udhëzimit nr. 23, datë 22/11/2016 "Për procedurat standarte ië përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit Vjetor nr. 6, datë 28/02/2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"

Situata aktuale e funksionit: Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, janë hartuar duke u bazuar në objektivat e zhvillimit të Bashkisë, të cilat lidhen me funksionet respektive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara në kuadrin ligjor, në nivel programi, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose me shumë njësi Dokumenti i PBA-së, prezanton qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program duke u fokusuar në programet më prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit

Ky projekt afatmesëm bazohet në vizionin tonë për Fushë-Arrëzin, i cili para së gjithash duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshem, me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjelbërta të dedikuara për fëmijët dhe të moshuarit. Ne jemi të bindur se pavarësisht problemeve të shumta, qyteti i Fushë Arrëzit mbart një potencial të konsiderueshëm ekonomik, social e kulturor.

Situata financiare : Bashkia Fushë Arrëz parashikon të shpenzojë për vitet ardhshme:
Për vitin 2026 - 403,097,494 Lekë
Për vitin 2027 – 407,018,857 Lekë
Per vitin 2028 – 410,858,888 Lekë

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Procesi i hartimit të Programi Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor per vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkise.

Komisioni i Përhershëm për “ Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 25/03/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.8 datë 07/03/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda

(emri, mbiemri, firma)



Kryetar i Komisionit

Besjana Marku

(emri, mbiemri, firma)



Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I EKONOMISË FINANCË BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK



Nr. 861 prot.

Fushë-Arrëz, më 25.03.2025

**PËR : KËSHILLIN E BASHKISË
FUSHË-ARRËZ**

Relacion i Komisionit të Ekonomisë Finance Buxhetit Mbikqyrjes Financiare Planifikimit të Zhvillimit Strategjik mbi Projektvendimin për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mbledh sot më, 25.03.2025, Komisioni i Ekonomisë Finance Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit). Gjithashtu i pranishëm ishte, Përgjegjësi i Finances Z.Dritan Lika, i cili dha shpjegime për projektin e mësipërm.

Përgjegjësi i finances Z.Dritan Lika shpjegoi se , Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, janë hartuar duke u bazuar në objektivat e zhvillimit të Bashkisë, të cilat lidhen me funksionet respektive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara në kuadrin ligjor. në nivel programi, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë njësi.

Dokumenti i PBA-se, prezanton qellimet, objektivat dhe produktet për çdo program, duke u fokusuar në programet me prioritet, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

Ky projekt Afatmesëm bazohet në vizionin tonë për Fushe-Arrezin, i cili para se gjithash duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshëm, me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrjet, me një jete kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjerë të dedikuara për fëmijët dhe të moshuarit.

Ai thotë se, ne jemi të bindur se pavarësisht problemeve të shumta, qyteti i Fushe Arrezit, mbart një potencial të konsiderueshëm ekonomik, social e kulturor.

Përgjegjësi i Finances Z.Dritan Lika thekson se:

Objektivi themelor i këtij Programi Afatmesëm është përmirësimi në vazhdim i cilësive të jetesës në Bashkinë e Fushe Arrezit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore, përmirësimi të kushteve në qerdhe, kopshte e shkolla, ofrimin të shërbimeve

sociale cilesore, ritjes se punesimit dhe zhvillimit te ekonomise rurale, turizmit, etj.

Z. Lika shpjegon gjithashtu se parashikimi i te ardhurave e shpenzimeve eshte bazuar ne:

1. Paketën fiskale te Bashkise se Fushë Arrez.
2. Shperndarjen e burimeve në perputhje me prioritetet e zhvillimit te qytetit.
3. Prioritetet e qyetetarëve të evidentuara giate takimeve në çdo nesi administrative.

Shtyllat kryesore në të cilat eshte mbështetur hartimi i tavanave të Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028, janë :

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit;
- Garantimi i pastertise se qytetit dhe i cilesise së ajrit;
- Ofrimin e sherbimeve cilësore;
- Permirësimin e infrastrukturës arsimore;
- Përmiresimin e infrastruktures rrugore;
- Nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, te cilat ndikojnë ne shëndetin e popullates;
- Gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike, nepermjet mbeshtetjes se projekteve;
- Mbështetja e turizmit.

Në çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet, duke perfshire funksionet e veta dhe funksionet specifike, sipas llojit dhe njësive shpenzuese, ku perfshihen :
Shpenzimet, Programet ekonomike, Tavanet e Shpenzimeve.

Permes Tabelave ne Monitor jepen detajet lidhur me:

Totalin e shpenzimeve per çdo Program;

Planifikimin, Menaxhimin dhe Administrimin;

Sigurine publike;

Zhvillimin Ekonomik dhe Rural;

Arsimin, Kulturen, Sportin, Çeshtjet Sociale;

Punet Publike;

Fondin Rezerve dhe Kontigjence.

Z. Lika thekson se ky dokument, hartimi i Tavanave Pergatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Bashkinë Fushë Arrez, eshte hartuar nga administrata e Bashkisë, nëpërmjet "Grupit për Menaxhimin Strategjik".

Programi Buxhetor Afatmesem është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Bashkisë Fushë Arrëz me nevojat e qytetarëve dhe që do të shërbejë si baze për planifikimin e shpenzimeve korente dhe kapitale për periudhën 2026-2028, duke prezantuar politikat financiare afatmesme të Bashkisë.

Gjithashtu, ky program u shërben të gjitha EMP pasi përcakton në mënyrë të qartë politikat për çdo program dhe u jep mundësi të përcaktojnë kostot dhe prioritetet e tyre për çdo aktivitet, brenda kontekstit të mundësive të disponueshme financiare.


Pasi perfundoi diskutimi anëtarët e komisionit rane dakord me **shumicë votash** duke e dërguar projektvendimin për shqyrtim të mëtejshëm dhe miratim në mbledhjen Plenare të datës 26.03.2025.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

PER KOMISIONIN:

Kryetar

Franc DODA



Sekretar

Besjana Marku



Anëtar komisioni

Valentini Doci

Anëtar komisioni

Valentina Llesaj My.